

V E N D I M
Nr. 527, datë 31.10.2002

PËR PRONËSINË DHE ADMINISTRIMIN E AERODROMIT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 68 të ligjit nr. 7877, datë 30. 11. 1994 “Për aviacionin civil” dhe të neneve 3, 6, 13 e 14 të ligjit nr. 8743, datë 22. 2. 2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Aerodromi i Vlorës të jetë pronë e paluajtshme e shtetit me statusin e pronës së paluajtshme publike. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil, të jetë organi shtetëror përgjegjës për administrimin e këtij aerodromi.

2. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil, të marrë masa për riaftësimin dhe administrimin e Aerodromit të Vlorës.

3. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil dhe bashkia e Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano